



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË**  
OSNOVNI SUD DJAKOVICA – BASIC COURT OF GJAKOVË

---

**AD/GJTHGJA. nr. 02/2023**

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË** – Kryetari i Gjykatës Nikollë Komani, në çështjen e hetimit disiplinor ndaj gjyqtarit B.B, duke vepruar sipas ankesës së parashtruar nga S. (A.) K. nga fshati Ratkoc Komuna Rahovec, pas shikimit të shkresave të lëndës dhe vlerësimit të ankesës, me datë 24 prill 2023 mori këtë:

**A K T V E N D I M**

Refuzohet ankesa disiplinore e parashtruar nga S. (A.) K. nga fshati Ratkoc Komuna Rahovec, ndaj gjyqtarit B.B, si e pabazuar.

**A r s y e t i m**

Parashtruesi i ankesës, S. (A.) K. nga fshati Ratkoc Komuna Rahovec, me datë 29 mars 2023, ka dorëzuar padi për anulimin e aktvendimit të kundërligjshëm PPP. 109/2019 të datës 08.03.2023, mirëpo me këtë padi ka kërkuar që gjyqtari B.B, të përgjigjet para komisionit disiplinor të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, të cilës padi i'a ka bashkangjitur aktvendimin PPP.nr.109/2019 së bashku me prova tjera.

Pas pranimit të kësaj padie dhe pas analizimit të përmbajtjes së saj, e njëjta është regjistruar në librin e ankesave disiplinore me nr. AD/GJTHGJA.nr.02/2023, datë 29 mars 2023 dhe janë ndërmarrë të gjitha veprimet ligjore që janë në kompetencë të kryetarit të Gjykatës, sipas Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore për Gjyqtarë dhe Prokurorë. Ndërsa padia me provat e bashkangjitura është regjistruar si lëndë e rregullt, e cila do të trajtohet në procedurë gjyqësore.

Me shkresën AD/GJTHGJA.nr.02/2023 të datës 31 mars 2023, është njoftuar Këshilli Gjyqësor i Kosovës, se janë ndërmarrë veprimet lidhur me ankesën e parashtruar nga ana e ankuesit.

Ankuesi Sahit Kastrati, ka ushtruar padi kundër: “1. Kompania Kosovare për F. E. E. Sh. A K.....- dega në Gjakovë; 2. Gjyqtarit B.B; 3. F. (A.) K. nga fshati Ratkoc për anulimin e aktvendimit të kundërligjshëm PPP. nr. 109/2019 të datës 08.03.2023. Përmes kësaj padie ka theksuar se të gjitha të dhënat dëshmojnë se gjyqtari B.B ka nxjerr Aktvendim të kundërligjshëm nga neni 425 të KP në fuqi nga data 15.04.2019 për borgj inekzistent ndaj S.K për shumën prej 756.23 €, si dhe gjyqtari B.B ka bërë keqpërdorim të pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 414 të KP në fuqi prej 15.04.2019, ka bërë shkelje të nenit 326.1 dhe 329 për të bërë fuqinë provuese të shkresave të Ligjit për Procedurën Kontestimore, për faktin se Gjykata nuk ka ardhur me e bërë kqyrjen në vend në fuqi prej 16.10.2008. Ka kërkuar që gjyqtari B.B të suspendohet nga marrëdhënia e punës dhe të përgjigjet para komisionit disiplinor të Këshillit Gjyqësor të Kosovës për shkak se ka nxjerr aktvendim të kundërligjshëm nga neni 425 me shkelje të nenit 414 dhe 423 të KP në fuqi prej 15.04.2019, si dhe ka bërë shkelje të nenit 326.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore”.

Gjyqtari B.B, në deklaratën e tij të dhënë me shkrim ka theksuar se: *“në çeshtjen përmbartimore të debitorit S.K nga fshati Ratkoc Komuna Rahovec, lënda është trajtuar në mënyrë serioze dhe profesionale. Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe prapësimit të debitorit me aktvendimin PPP. nr. 109/2019 të datës 08.11.2022, kam vendosur që të refuzoj prapësimin dhe e kam lënë në fuqi urdhërin e përmbartuesit. Pasi që është ekspeduar ky vendim debitori ka ushtruar ankesë në afat ligjor dhe pas ankesës së debitorit S.K konform nenit 77 të LPP-së, me aktvendimin PPP. nr. 109/2019 të datës 08.03.2023 e kam urdhëruar debitorin që të paguaj shumën e garancionit me qëllim që ankesa e tij të trajtohet në Gjykatën e Apelit edhe pse i njëjti nuk e ka deponuar shumën e garancionit, respektivisht nuk e ka respektuar vendimin e gjykatës, unë pavarësisht kësaj me akt përcjellës lëndën e kam përcjell në Gjykatën e Apelit. Veprimet e debitorit duke më paditur dhe duke ngritur procedurë disiplinore ndaj meje janë të ngutshme pasi që lënda në fjalë është në trajtim e sipër në Gjykatën e Apelit, andaj ju lë që të vlerësoni pretendimet e palës dhe të vendosni drejtë në trajtimin e kërkesës së palës”.*

Kryetari i Gjykatës, lidhur me këtë çështje-ankesë përmes programit të SMIL-it ka siguruar shkresat e lëndës PPP.nr.109/19 nga të cilat vërtetohet se gjyqtari B.B, ka vepruar si gjyqtar i procedurës përmbartimore, e ku duke vendosur në prapësimin ndaj propozimit për përmbartim të ushtruar nga ana e debitorit-ankuesit, me datën 08.11.2022, ka nxjerr aktvendimin PPP.nr.109/2019. Kundër këtij aktvendimi debitori-ankuesi, me datë 15.11.2022 ka parashtruar ankesë në Gjykatën e Apelit dhe pas ankesës së debitorit-ankuesit, gjyqtari me aktvendimin PPP.nr.109/2019 të datës 09.03.2023, ka kërkuar nga debitori të paguaj shumën e garancionit si parakusht për ankesën tij të datës 15.11.2022, të ushtruar kundër aktvendimit PPP.nr.109/2019 të datës 08.11.2022.

Kryetari i Gjykatës, pas analizimit dhe vlerësimit të ankesës së ankuesit, shkresave të lëndës dhe deklaratës së gjyqtarit, gjeti se ankesa është e pabazuar.

Kryetari i gjykatës, ka vlerësuar dhe analizuar pretendimet e ankuesit të paraqitura ndaj gjyqtarit B.B, vetëm sa i përket pretendimeve për shkelje disiplinore dhe ka konstatuar se këto pretendime janë të pabazuara për faktin se gjyqtari, me rastin e vendosjes lidhur me këtë çështje ka vepruar në kuadër të autorizimeve të tij si gjyqtar i procedurës përmbartimore. Arsytet në të cilat ankuesi e ka mbështetur ankesën disiplinore, janë pretendime ankimore të cilat ankuesi i ka paraqitur edhe në ankesën e datës 15.11.2022 drejtuar Gjykatës së Apelit, si gjykatë kompetente për t'i vlerësuar dhe analizuar këto pretendime ankimore. Këto pretendime ankimore të ankuesit nuk hyjnë në domenin e shkeljeve të natyrës disiplinore të përcaktuara në mënyrë taksative me nenin 5 par.1 dhe 2 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, por janë pretendime ankimore të cilat do të vlerësohen dhe analizohen nga gjykata e shkallës së dytë, si gjykatë kompetente për të konstatuar se me rastin e vendosjes nga ana e gjyqtarit në këtë procedurë përmbartimore a janë respektuar dhe a janë aplikuar drejt dispozitat ligjore me rastin e marrjes së këtyre vendimeve për të cilat ankuesi ka ushtruar ankesë.

Andaj, mbi këto baza konstatohet se në veprimet e gjyqtarit nuk janë konstatuar shkelje të cilat do të konsideroheshin shkelje disiplinore, për këtë arsye kryetari i Gjykatës gjeti se pretendimet ankimore janë të pabazuara, pasi nga të lartcekurat nuk rezulton se veprimet e ndërmarra nga gjyqtari B.B, përbëjnë bazë për iniciimin e procedurës disiplinore në Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Nga arsyet e theksuara më lartë, si dhe duke u bazuar në dispozitat ligjore të nenit 9 par. 6 të Ligjit nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, dhe nenit 7 par. 3 pika 3.2 të Rregullores 05/19 për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË**  
**AD/GJTHGJA. nr. 02/2023, datë 24.04.2023**

**Kryetari i gjykatës**  
**Nikollë Komani**

**Vendimi t'i dorëzohet:**

1. Këshillit Gjyqësor të Kosovës,
2. Parashtruesit të ankesës,
3. Gjyqtarit/es,